

Kreshma e Krishtlindjes, 15 nëntor - 24 dhjetor



Për të gjithë besimtarët e krishterë orthodhoksë data 15 nëntor daton me fillimin e periudhës së përgatitjes për festën e madhe dhe shumë të rëndësishme të Krishtlindjes, pra me fillimin e Kreshmës. Kjo është një prej periudhave kreshmore që Kisha ka vendosur si kohë përgatitore për të pritur denjësisht festat e mëdha.

Kreshma e Krishtlindjes është kreshmë e gëzueshme, sepse edhe vetë ngjarja, Lindja e Krishtit, e cila kremtohet në 25 dhjetor, solli gëzim shumë të madh (Matheu 2:10). Gjatë kësaj periudhe të përcaktuar nga Kisha, ne përgatitemi me kreshmë dhe paralelisht përjetojmë të gjithë himnologjinë e po kësaj periudhe, në mënyrë që të jetojmë ngjarjen e madhe të Ardhjes së Perëndisë në tokë.

Kreshma është bashkëpunim i pjesës materiale të trupit tonë në adhurimin e Perëndisë së gjallë. Duke kreshmuar me disa ushqime dhe nga ana tjetër duke kreshmuar nga mëkatet, ndihmojmë të gjithë njeriun, trup e shpirt, të afrohet e të adhurojë Perëndinë. Çdo e kremte, çdo festë kishtare nuk është një paraqitje e thjeshtë, e jashtme e disa ngjarjeve të kaluara, por në çdo të tillë ne rijetojmë si person ato ngjarje sikur të ndodhin sot. Kështu, gjatë periudhës së Kreshmës, njeriu parapërgatitet për të pranuar Shpëtimtarin Krisht që do të lindë në grazhd.

Kreshma është biblike. Kreshma na është dhënë nga vetë Krishti, i Cili para se të

fillonte veprën shpëtimtare në tokë, pas pagëzimit të Tij, qëndroi në shkretëtirë 40 ditë, duke mbajtur keshmë (Mattheu 4:1-11). Keshma nuk është diçka që gjeti fantazia jonë, por është një mënyrë që njeriu pastrohet dhe përpigjet t'i dhurojë diçka Perëndisë dhe kjo keshmë është përmendur që në Dhiatën e Vjetër.

Këtë traditë përvojë e vazhdoi dhe e përjetoi me shembullin e tij edhe vetë Zoti, siç edhe është përmendur.

Në këtë mënyrë edhe ne parapërgatitemi për ardhjen e Perëndisë në tokë me keshmë 40-ditore. Në këtë keshmë ne privohemi nga prodhimet blegtorale (mish, vezë, qumësht, djathë, gjalpë etj) dhe paralelisht me këto ne përpigemi të bëjmë edhe një reflektim mbi jetën dhe veten tonë, duke mos e shndërruar Keshmën në një dietë dhe në “poza”, por në një shqyrtim të vërtetë e të thellë pendimi të vetës dhe të gjendjes sonë mëkatore.

Keshma është mjet, jo qëllim! Keshma na ndihmon dhe na krijon atmosferën për lartësimin shpirtëror. Besimtarët gjatë kësaj periudhe urojnë njëri – tjetrin: “Keshmë të mbara dhe të gëzuara!”

Le të përpigemi pra, të gjithë, sa mundemi, të përgatisim grazhdin e zemrës tonë, që të lindet brenda saj Krishti foshnje, Shpëtimtari i botës! Le ti lutemi Zotit me fjalët e një prej uratave të Shërbesës së Kungimit: “...dhe siç denjove të shtrihesh në shpellë dhe në grazhd të kafshëve, denjo të hysh edhe në grazhdin e shpirtit tim të paarsyeshëm dhe të trupit tim të njollosur.”

Krishtlindje të bekuara!

Sonila (Dedja) Rëmbeci

Kujtojmë:

Në Keshmë nuk hahen mishi dhe nënproduktet e tij, as veza dhe produktet bulmetore.

Lejohen peshku, frutat e detit, perimet, vaji dhe frutat.

Peshku lejohet deri ne dt. 17 dhjetor. Peshku, vaji e vera nuk lejohen të mërkurave dhe të premteve.

Nga data 17 deri më 24 Dhjetor, kreshma bëhet më e fortë, ku peshku nuk lejohet dhe vera e vaji lejohen vetëm të Shtunave dhe të Dielave.

Shënim i rëndësishëm:

- Kalendari ynë kishtar është hartuar në mënyrë të tillë që të na drejtojë me zell në rrugën e duhur në jetën tonë shpirtërore. Në të ka shumë ditë kreshmimi, të cilat na përgatisin për ditët e festave.

- Gjithashtu është e këshillueshme që çdo i krishterë orthodhoks të këshillohet me atin shpirtëror (prifti që rrëfëhemi) përse i përket nevojave personale për të kreshmuar.

- Ka mënyra të ndryshme kreshmimi që varen nga udhëzimi i atit shpirtëror (priftit që rrëfëhemi).

- Gjatë gjithë kreshmës Kisha rekomandon pakësimin e sasisë së ushqimit që konsumojmë çdo vakt dhe të mos hahet ndërmjet vakteve. Disa kanone dhe Etër të Kishës rekomandojnë, për ata që munden, të hanë vetëm një vakt në ditë.

- Të kreshmojmë (të mos hamë) disa ushqime dhe pije që na pëlqejnë më shumë (ëmbëlsira, alkool) dhe për disa zakone (të pirit duhan, të pakësimit të të parit televizor dhe të dëgjimit të radios).

- Të bisedojmë me atin shpirtëror dhe të marrim bekimin e tij për arsye shëndetësore (si gratë shtatëzëna dhe raste të tjera të veçanta).